

TRAJNIME ME STUDENTE DHE STAF NE KUADER TE PROJEKTIT OASIS



Në kuadër të projektit OASIS, u zhvillua trajnim me disa të rinj që studiojnë në programe të fushës së ekonomisë, të interesuar për përdorimin e teknologjisë së shkencës së hapur për nxitjen e përfshirjes së studentëve në sipërmarrje, etj si dhe trajnimi me stafin akademik dhe administrative te Kolegjit Universitar “LOGOS” .

Trajnimi i zhvilluar me studentët nisi me prezantimin e Projektit OASIS, objektivat dhe hapat që do të ndiqen, si edhe roli i studentëve në këtë projekt. Trajnimi ishte efektiv dhe interaktiv duke u konfirmuar interesimi i studentëve për zhvillimin e tyre duke u mbështetur në shkencën e hapur (Open Science) për të nxitur transformimin dixhital dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të qëndrueshme. Studentët shprehën interesimin e tyre për të shërbyer si trajnerë apo mentorues për të rinj të tjerë të interesuar për përfshirjen në sipërmarrje të reja. Për këtë qëllim seancat e trajnimit dhe mentorimit për këta të rinj do të vijojnë edhe gjatë vitit 2023.

Gjithashtu në kuadër të objektivave të projektit OASIS, me një grup më të vogël

studentësh u zhvillua edhe një seancë mentorimi për një grup më të vogël studentësh. Në një të ardhme të afërt përgjatë vitit 2023, përmes projektit OASIS do të ngrihet një platformë komunikimi e pajisur me mjetet e nevojshme ku do të vendosen materialet trajnuese pa pagesë për çdo të interesuar.

Trajnimi i zhvilluar me stafin akademik dhe administrative nisi me prezantimin e Projektit OASIS, objektivat, partnerët dhe hapat që do të ndiqen. Gjithashtu, u diskutua mbi rëndësinë e trajnimit mbi 'Shkencën e Hapur', avantazhet dhe disavantazhet dhe shtyllat e saj si dhe praktika të tjera të rëndësishme.



ntorimi të









Kolejji Universitar “LOGOS”